



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 15 shtator 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Caktimin e Trupit Gjykues I

Gjykatësve të Trupit Gjykues I:

Gjykatës Roland Dekers
Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Gjykatës Zhilber Biti
Gjykatës Vladimir Mikula (rezervë)

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtjes së Pjetër Shalës:

Zhan-Lui Zhilisen

Mbrojtësit të viktimave:

Sajmon Loz

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), në bazë të neneve 33(1)(b) dhe 40(1) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullave 98(3) dhe 115 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe rregullave 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton Trupin Gjykues I pas njoftimit nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake se dosja e plotë e kësaj çështjeje gjyqësore do të jetë gati për t’iu kaluar Trupit Gjykues më 21 shtator 2022 (“Njoftimi”).¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 12 qershor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër Pjetër Shalës, versioni i redaktuar i së cilës u bë publik më 6 maj 2021.²
2. Më 16 mars 2021, Shala u arrestua në Belgjikë në bazë të një fletarrestimi të lëshuar nga Gjykatësi i Vetëm më 12 qershor 2020³ dhe më 15 prill 2021 u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë.⁴
3. Më 15 shtator 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake dorëzoi njoftim në përputhje me rregullën 98(3) të Rregullores, ku informonte se dosja e kësaj çështjeje gjyqësore do të jetë gati për t’iu kaluar Trupit Gjykues më 21 shtator 2022.⁵

¹ F00275, Njoftim në bazë të Rregullës 98(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, 15 shtator 2022.

² *Shih* F00007, Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës, 12 qershor 2020 (konfidencial); F00007/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit për Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës, 6 maj 2021.

³ *Shih* F00008/A01, Fletarrestim për z. Pjetër Shala, 12 qershor 2020 (konfidencial). Versioni i redaktuar publik i fletarrestimit u dorëzua më 15 prill 2021. *Shih* F00008/A01/RED.

⁴ *Shih* F00019, Njoftim për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit, 15 prill 2021.

II. CAKTIMI

4. Pas shqyrtimit të kriterëve të përcaktuara në rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

KRYETARJA MË KËTË VENDIM CAKTON TRUPIN GJYKUES I,

I PËRBËRË NGA:

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatëse Mapi Feld-Folia

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula (rezervë)

për këtë çështje gjyqësore pas kalimit të dosjes gjyqësore më 21 shtator 2022.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare e Dhomave të Specializuara

E enjte, 15 shtator 2022
Në Hagë,
Holandë

⁵ *Shih* Njoftimin.